

NP “Parqe dhe gjelbërime”, do të realizojë shitjen publike:

ANKANDI I PARË

Lënda e shitjes është:

- Makina dhe pajisje të tjetërsuara – në gjendje jofunksionale, të theksuar sipas vlerësimit përkatës, me çmim fillestarë prej 9.00 denarë / kilogram.

Shitja publike do të realizohet në datën 24.01.2018, në hapësirat e NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, në adresën “Ilindenska” nr. 104, para magazinës në Shkup, në ora 10.00.

Të drejtën e pjesëmarrjes në shitjen publike – ankandi i parë, e kanë të gjithë personat fizik dhe juridik që shprehin interesim dhe të cilët do të paguajnë 1.000,00 denarë në emër të garancisë për pjesëmarrje, më vonë deri më datën 23.01.2018, në gjiro llogarinë e NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, numri i gjiro llogarisë 300000000114205 në Komercijalna banka SHA Shkup, NVT 4030992176467.

Qëllimi i pagesës : garancia në shumën prej 1.000.00 denarë për pjesëmarrje në ankand.

Nëse personat fizik dhe juridik të interesuar, nuk do të paguajnë pjesëmarrjen për shitjen publike dhe nëse me vete nuk e sjellin dëshmitë – urdhëresën pagesore të paguar, nuk do të gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në këtë ankand.

Informacionet plotësuese, personat e interesuar do të mund ti fitojnë në kontakt telefonin 075/211-407 z. Eroll Kubur, çdo ditë pune nga ora 08.00 deri në ora 14.00.

Ofertuesit më të volitshëm – blerësit, shumës së ofruar do ti llogaritet edhe 18% TVSH të cilën shumë e paguan blerësi.

Të gjitha shpenzimet do të pasojnë nga shitja e lartpërmendur, bien në barë të blerësit.

Ofertuesi më i volitshëm – blerësi, është i detyruar që mjetet e sendeve – lëndë e ankandit, ti paguaj në afat prej 3 ditëve në gjiro llogarinë e NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, numër 300000000114205 në Komercijalna banka SHA Shkup, NVT 4030992176467. Nëse i njëjti nuk e realizon pagesën e shumës së përcaktuar, atëherë ofertuesi më i volitshëm e humb të drejtën e pjesëmarrjes në shumën prej 1.000,00 denarë, në emër të garancisë për pjesëmarrje.

Pas përfundimit të ankandit, përkatësisht pas realizimit të pagesës nga ana e pjesëmarrësit të parë të ranguar, pjesëmarrësve tjerë në ankand iu kthehen mjetet e paguara në emër të garancisë për pjesëmarrje.

KOMISIONI PËR SHITJE